



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

|  |   |  |                                       |
|--|---|--|---------------------------------------|
| <i>Majlinda Bedrolli</i><br><i>Ekspert shqyrtues</i> | <i>Data e autorizimit të ekspertit</i><br><i>28.06.2022</i> | <i>Data e dorëzimit të raportit</i><br><i>01.07.2022</i> | <i>Nr. i lëndës:</i><br><i>233/22</i> |
|--|---|--|---------------------------------------|

**1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: 27.06.2022, OE ankues NTSH “**Dardani**”- **Kaçanik**, ka parashtruar ankesë me nr: **233/22**, LOT -2, kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik **Metë Muriqi B.I** (NTP “**Dromodoli Comerc**”) për LOT-2., lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Shitja e mased drusore sipas planit operativ 2022**” me nr.të prokurimit: **KA652/22/036/2610**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna – Kaçanik.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur lloji i kontratës: Ankan publik, shitje të aseteve përmes ofertimit publik .

Ftesa për ofertim për shitje 29.04.2022, Njoftimi për Vendimin e AK 06.06.2022, Afati i fundit i dorzimit të tenderit 10.05.2022, Kriteri i dhënis se tenderit:tenderi i përgjegjshëm me qmim dhe faktorët tjerë a) **Kërkesat minimale për kualifikim dhe b) Çmimi më i lartë**, Qasja ne dokumentacionin tenderik me dt 10.06.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## **2. PRETENDIMET ANKIMORE**

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:

**Neni 7, dhe 59 të LPP-së, si dhe**

**U.A. me nr. 15/2006 për standardet dhe kushtet për licencimin e përpunuesve të produkteve drunore.**

**U.A. me nr. 03/2008 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e licencave për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore.**

**U.A. me nr. 06/2010 për mënyrën dhe procedurat e shitjes së trungjeve pyjore dhe asortimenteve drusore nga pyjet publike.**

### **DEKLARATA DETALE E ANKESES**

Me dt: 13.06.2022 kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim kompania jonë NTSH “Dardani” –Kaçanik (me tej: Kërkuesi) Brenda afatit ligjor të paraparë me dispozita e nenin 109 të LPP-së, për kërkesën për rishqyrtim respektivisht Brenda afatit të lenë për kërkesën paraqet këtë:

**KERKESE PER RISHQYRTIM PER LOT -2**

Për shkak të:

Konstatimit të gabuar të gjendjes faktike

Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale

Me të cilën kërkesë Kërkuesi godet në tersi aktvendimin, përshkruar me lartë, si akt administrativ të paqëndrueshëm të ngutshëm subjektiv dhe absolutisht të pabazuar dhe Propozon që Kërkesa e paraqitur për rishqyrtim ta miratoj si të bazuar në Ligj , Vendimin për tenderuesin e suksesshëm ta Anuloj-dhe AK të vazhdon me tutje me procedurën e prokurimit për projektin e lartpërmendura.

Me datën 06.06.2022 nëpërmjet platformës email-it dhe platformës elektronike të KRPP-së e-prokurimit kemi pranuar letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm për LOT-2 si dhe njoftimin mbi Vendimin e AK i cili shpërblen me kontratë OE Metë Muriqi B.I (NTP ”Dromodoli Comerç”) për LOT-2.

Ne letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm –Tenderi juaj nuk është me çmimin me të lartë i cili ishte kriter për dhënien e kontratës por gjithashtu fillimisht OE duhet të plotësonte kushtet sipas ftesës për ofertim dhe dosjes së tenderit.

Me dt:05.06.2022, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderit dhe kemi pasur qasje me datën 10.06.2022.

**Pretendimi i parë**-Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi- Sipas nenit 7 të LPP-së pika 1 dhe 2 shkruan: Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Bazuar në këto që u cekën në nenin 7 të LPP-së, ne kemi vërejtur menjëherë pas njoftimit për kontratë kur ju si AK i keni vendosur kriteret të cilat kanë qenë favorizuese dhe diskriminuese.

AK ka diskriminuar kompaninë tonë për faktin se ka shpërblyer me kontratë OE i cili ka qenë i dënuar nga Gjykata kompetente për dëme pyjore e cila çeketat në vërtetimin e APK-s, ku ju si AK keni kërkuar vërtetimin nga APK që nuk duhet të kenë dënime dhe në atë vërtetim të kompanisë "Dromodoli Comerc" çeket qartë se ka qenë i dënuar për dëme pyjore.

Ju keni kërkuar sqarim nga Inspektorati qendror i Kosovës ku shumë kështu shifet përgjigjja lidhur me kërkesën tuaj ku specifikon: CITIM-me anë të secilës ja kemi konfirmuar se jo vetëm që ka procedurë të iniciuar por kemi edhe Aktgjykim të Gjykatës me dënim që ka vërtetuar procedurën tonë.

Ku keni faktet edhe të dy vërtetimeve të ndryshme nga APK-ja (me datën 16.06.2021 ka marr një vërtetim se nuk ka dënime për vazhdimin e licencës, ndërsa me datën 04.05.2022 ka marr vërtetimin se kompania në fjalë ka pas dënime dhe të Formës së prere.

AK përkatësisht Agjencia Pyjore e Kosovës ka ra në ndesh me vërtetën duke lëshuar dy vërtetime të kundërta por një qëllimshme se bashku me AK duke favorizuar OE "Dromodoli Comerc" dhe ne si kompani shumëvjeçare që mirremi me këtë aktivitet na diskriminojnë dhe dëmtojnë.

AK veçanërisht APK ka të hartuar Udhëzime Administrative ku janë të parapara sanksionet për kompanitë të cilat ka kallëzime penale e në veçanti rasti i OE "Dromodoli Comerc" ka dhe Aktgjykim të prerë nga gjykata kompetente dhe cilat janë masat që janë ndërmarr për këtë OE që parashihen me Udhëzime Administrative ku janë të parapara sanksionet për kompanitë të cilat ka kallëzime penale e në veçanti rasti i OE "Dromodoli Comerc" ka dhe Aktgjykim të prerë nga gjykata kompetente dhe cilat janë masat që janë ndërmarr për këtë OE që parashihen me Udhëzim Administrativ me **nr.15/2006** neni 15 *Licenca mund ti hiqet personit (subjektit) nëse vepron në kundërshtim me ligjin dhe kushtet e licencës dhe Udhëzim Administrativ me nr.30/2008* neni 11 Citon "Departamenti i Pylltarisë mbi bazën e provave të vërtetuara nga inspeksioni i pylltarisë organi kompetent menaxhues me pyjet dhe organe tjera kompetente ia heq të drejtën e përdorimit të licencave për një periudhë prej 2 deri në 5 vjet, subjekteve juridike nëse:

- a) *Me veprimtarinë e tyre kanë shkaktuar dëme ose kundërvajtje në pyje;*
- b) *Janë shkaktarë të mos shlyerjes së detyrimeve kontraktuese gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre dhe*
- c) *Gjatë zhvillimit të aktivitetit me veprimin ose mosveprimin e tyre shkaktojnë shkelje te këtij Udhëzimit Administrativ dhe dispozitave ligjore në fuqi.*

Menjëherë është dashtë qe për këtë procedure te behet eliminimi i OE pasi që ju si AK nuk keni sanksionuar këtë OE por e keni favorizuar se bashku me APK-në, duke ja dhanë mundësinë për mesë vërtetimeve që favorizojnë për të marrë kontrata në shfrytëzimin e pyjeve në Kuvendet Komunale në nivel të Kosovës, duke i shkelur Udhëzimet Administrative të departamentit të APK-s.

Edhe në dokumentacionin tjetër të OE "Dromodoli Comerc" shifet se në listën e Mjeteve themelore ka të cekura dy traktor të marr me qera nga një OE tjetër i cili nuk posedon dokumentacion që përmban në emrin e tij, nuk posedon as librez të qarkullimit të traktorëve sipas mendimit ton jo valide.

Gabimet që kemi parë në dokumentacionin e OE "Dromodoli Comerc" në dëshmi nga DBZHRP-je komunale kemi hasur në nr. e biznesit 80237707 ku te deklaruar ka tatimet 00.00 e qe nuk përputhen me nr.e biznesit që posedon në Licencë.

Në vërtetim nga APK përpos dënimit qe kemi te cekur vërtetimi nuk përmbana nr. e biznesit të OE që saktëson pjesën e të dhënave të kompanisë.

Në informatat e biznesit kemi parë që OE në fjalë nuk përmban as kodin me nr. 0220 i cili specifikon "Prerjen e Drunjeve"

Ne si kompani do ti ndjekim të drejtat tona përmes OSHP. Bazuar ne këto kërkesa ju si AK keni favorizuar një OE ku keni bere shkelje te parimeve bazike te prokurimit.

Konkurrenca,

Efikasiteti &Efektivitetit

Drejtësi/Mos-diskriminim

Objektivitet/integritet /sinqeritet

Transparenca

Llogaridhënie dhe

Profesionalizëm

#### **Pretendimi i dytë-Ekzaminimi Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve-**

Komisioni i vlerësimit nga ana juaj ka pasë për qellim qe tenderët të ekzaminohen vlerësohen dhe krahasohen

në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në Ftesën për ofertim /dosjen e tenderit dhe kontrata do ti ipet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Këtë qellim komisioni i vlerësimit nuk e ka kryer pasi për mendimin tone ai ka qenë subjektiv dhe favorizues.

OE “Dromodoli” ka afruar çmime aq të larta sa që nuk korrespondojnë me çmimet e tregut duke pas të vetmin qellim që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale përndryshe me këto çmime OE nuk mundë të realizoj kontratën konform kushteve të kontratës.

Nëse, qëllimi i AK ka qenë që tenderuesit duhet të ofrojnë çmime të pa përballueshme dhe të pamundura që të realizohet kontrata kjo dmth që AK me qellim ka favorizua një kompani të papërgjegjshme dhe shkelës e ligjit vetëm për qëllime të përfitimit.

Gjithashtu duke pas parasysh që njësia menagjuese “Ahishta” është rezerva me kushte të veçanta dhe të shpërblehet një kompani e papërgjegjshme s’ka vend tjetër përveç favorizimit të OE Dromodoli nga AK që ta fus dhe ta dëmtoj atë vend përmes shkatërrimit pyjeve.

Bazuar në të gjitha që u ceken me lart kërkojmë nga ana e juaj që kërkesën tonë për LOT-2 ta Rishqyrtoni me kujdes dhe njëherit të aprovoni si të bazuar duke marrë:

#### VENDIM

**APROVOHET** si e bazuar kërkesa për Rishqyrtim e OE NTSH “Dardani” Korbulliq lidhur me Ftesën për ofertim: Shitja e masës drusore sipas planit operativ 2022 LOT-2 me referues **KA652/22/036/2610**

**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK .Të anulohet vendimi për shpërblim me kontratë për LOT-2 Metë Muriqi B.I (NTP” Dromodoli Comerc”)

**SHPERBLEN** me kontratë OE NTSH “Dardani” Korbulliq pasi oferta jonë të gjitha kriteret e kërkuara i plotëson në tërësi ,administrativisht teknikisht dhe me çmimin me serioz në konkurrim.

Me dt:21.06.2022 kemi pranuar vendimin nga AK mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pa bazë pas vlerësimit me arsyetimin si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin

Konstatim: OE Metë Muriqi B.I NTP “Dromodoli” ofron dëshminë nga AKP se i njëjti ofron dëshminë nga AKP me nr. APK-DL-103/2022 të dt.28.04.2022 konfirmohet se i njëjti nuk figuron si debitor dhe nuk ka obligime të pakryera, respektivisht i njëjti ka qenë i dënuar për kundërvajtje dhe të njëjti ka pas fletëparaqitje **për kundërvajtje me dt.18.05.2019**, nga Inspektorati por i njëjti me Aktgjykim me nr. **292/19 dt.29.07.2019** i ka kryer të gjitha obligimet dhe e njëjta nuk përben pengesë administrative për këtë procedurë.

Pretendimi për sa i përket se janë lëshuar dy vërtetime qëndron pasi që në sqarimet e kërkuara nga Drejtoria

Ligjore e APK-se konfirmohet lënda e cekur në dëshminë e lëshuar nga APK.

Pretendimi se të njëjtit është dashur ti merret Licenca i njëjti ka pru dëshmi respektivisht Licence nga Organi kompetent me nr. 28/2021 me validitet deri me 16.06.2026, ndërsa sa i përket

Pretendimi se të njëjtit është dashur ti merret Licenca është i bazuar mirëpo Revokimi i përket Departamentit përkatës bazuar në UA 15/2006 neni 15.

Për këtë aktivitet te Prokurimit OE ka prezantuar Licence valide nr. 28/2021 të dt.16.06.2021.

Bazuar ne kërkesën e DT është kërkuar Specifikacioni për Mekanizëm në dispozicion te cilin OE ka ofruar dëshminë, respektivisht Specifikacionin e mjeteve ne dispozicion.

Komisioni konstaton se bazuar ne dëshmitë e ofruara nga DT e OE NTP “Dromodoli”( Metë Muriqi B.I) i njëjti ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas Dosjes se Tenderit.

Sa i përket numrit te biznesit e njëjta ne dëshmitë e dorëzuara informatat për biznes është e cekur se numri i me parme i biznesit është **80237707**, mirëpo me zbatimin e ligjit mbi numrin unik identifikues te biznesit numri i ri është **810403337**, nga data 07.03.2019 dhe te gjitha dokumentacioni i OE Metë Muriqi B.I duet te jetë me numrin e ri NUI.

Sa i përket këtij pretendimi pjesërisht qëndron pasi qe OE Metë Muriqi B.I në dëshminë e dorëzuar nga Komuna e Pejës me nr. 74/22 të dt. 06.05.2022Vetetimi lëshohet me nr të biznesit 80237707, mirëpo bazuar ne te lartshënuarën është konstatua se ka te beje për te njëjtin biznes.

**Nga** ky arsyeje e AK vërehen qartë se kanë nxjerr vendim qe favorizon OE Dromodoli pasi qe ka arsye te qarta për anulimin e vendimit qe kanë marr edhe ato arsye ne përputhje me Dosjen e Tenderit.

Ne vendimin për refuzim pas rishqyrtimit nga AK vet komisioni i AK ka dëshmuar vetvetiu që është i dyshimtë për vendimin qe morr pasi që në disa pika ka shkruar fjalën Pjesërisht e qe ne dimë qe kjo fjalë nuk duhet te ekzistoj, por duhet te jetë e bazuar apo e pabazuar(PO/JO) dhe jo pjesërisht këtë e shihni është ne vendimin e AK të bashkangjitur.

AK ka kërkuar vërtetimin nga APK përkatësisht Inspektorati i Kosovës me qe rast OE Dromodoli ka sjellë vërtetimin nga APK ku ceket se OE ne fjalë ka pasur te ngritur fletëparaqitje ku nga zyrtari i përgjegjës qe lëshon vërtetimin është cekur qe kjo procedura nuk bën shkelje ligjore i njëjti zyrtar ne vitin 2021 e mshef dënimin dhe lëshon vërtetimin për licencim duke cekur qe OE nuk ka dënim ndërsa ne vitin 2022 e cek qe ka pas dënim por nuk bene shkelje dhe nuk i pengon për pjesëmarrje ne ankandet publike.

Këtu ka vend edhe për krime ekonomike.

AK kërkoi sqarime nga Drejtoria e Inspektoratit te Pylltarisë dhe pas përgjigjes se tyre shifet kjart se ka shkelje ligjore dhe ka pasur dënim te formës se prerë meqë përsëri AK nuk ka marr vendimin e duhur por përsëri ka

shpërblyer me kontratë OE Dromodoli.

AK ka kërkuar vërtetimin komunal OE në fjalë ka sjellë vërtetimin nga Komuna e Pejës ne te cilin shihet se nuk përmban numrin unik te cilin kompania e posedon ne Licenc –en e saj por përmban një numër tjetër e cila deklarimet tatimore i ka 00.00.

AK në DT ka kërkuar dy mjete motorrike traktora, OE ka sjell listën e mjeteve pika 6 dhe 7 qe posedon nga një kompani tjetër e me te cilën kanë bere kontratë formale pasi qe kompania qe ka dhëne ne shfrytëzim traktorat OE “Dromodoli nuk i posedon ne pronësi te veten sepse nuk ka dokumentacion ne emrin e tij personal apo ne emrin e biznesit te tij traktorat nuk kanë librezat te qarkullimit dhe ne këtë formë nuk mund as te epën ne shfrytëzim, sipas mendimit ton kjo kontrate për shfrytëzim është jo serioze e falsifikuar dhe jo valide.

Udhëzimet e lartë cekura kanë paraparë që OE të cilët në çfarëdo mënyre kanë shkaktuar ndonjë dëm apo kundërvajtje te sanksionohen me qellim qe te jenë të vetëdijshëm për pasojat te cilat mundë ti kenë nga këto veprime në dëmtimin e pyjeve ndërsa AK edhe pse është vënë ne dijeni se një OE jo vetëm qe ka pasur procedura kundërvajtës por edhe Aktgjykim me dënim i është lëshuar dokument me justifikimet te cilat kanë tejkaluar autorizimet e përpiluesit te vërtetimit APK-Drejtoria Ligjore , nga i cili është kërkuar hartimi i një dokumenti (Vërtetim) unik me procedura standarde ka apo nuk ka procedurë të iniciuar ashtu siç kërkohet me UA.

Ju lusim qe ankesa jonë të trajtohet korrekt dhe ti shqyrtoni edhe U.A që janë në fuqi nga AK-MBPZHR-APK, të cilat udhëzime administrative AK nuk i ka respektuar vetëm për te favorizuar OE me dyshime tona për krijimin te përfitimeve për vete apo t’ju mundësohet përfitime te tjerëve duke tejkaluar kompetencat dhe autorizimet zyrtare dhe dëmtuar konkurrencën e OE të përgjegjshëm te cilët zbatojnë Legjislacionin në fuqi.

Bazuar ne te gjitha qe u cen me lartë kërkojmë nga OSHP qe ankesën tonë të aprovoni si të bazuar duke marr:

## VENDIM

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e kompanisë sonë NTSH “Dardani” Korbulliq, pasi oferta jone te gjitha kriteret e kërkuara i plotëson ne tersi, administrativisht teknikisht dhe çmimin me serioz në konkurrim lidhur me Ftesen për ofertim: Shitja e masës drusore sipas planit operativ 2022 LOT-2 me referues **KA652/22/036/2610**

**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK .Të anulohet vendimi për shpërblyer me kontratë për LOT-2 Metë Muriqi B.I (NTP” Dromodoli Comerc”) dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

### 3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

|                    |      |   |
|--------------------|------|---|
| Hapja e Tenderit   | 17.1 | Hapja e tenderit do te bëhet me<br><b>10.05.2022</b> në orë<br>Vendi: <b>Zyra e prokurimit</b>  |
| Kriteret e Dhënies | 21.1 | <p><i>[Dhënia e kontratës do të bazohet në çmim me i lartë dhe në faktorët në vijim]</i><br/><i>[shëno faktorët]</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Regjistrimi i biznesit me shifrat e veprimtarisë. Përkatëse</li> <li>2. Çert. e nr. fiskalë nese nuk eshte ne cerrt. e biznesti. (kopje)</li> <li>3. Çert. e TVSH-se. (kopje)</li> <li>4.Licenca per eksploatimin e pyjeve -valide. (kopje)</li> <li>5. Dëshmia nga Gjykata kompetente se nuk është në procedur te ndjekjes të prerjes ilegale te pyjeve apo transport ilegal.</li> <li>6. Dëshmi nga DBZHRP-je (sektori i pylltarisë Kaçanik) se kunder subjektit përketes nuk ka te ngritur procedur për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime te pa kryera nga kontratat e mëparme.</li> <li>7. Dëshmi nga APK-Inspektorati qendror i Kosoves se kunder subjektit përketes dhe Menagjerit nuk ka te ngritur procedur për dëme pyjore.</li> <li>8.Planik dinamik. Jo më shumë se 40 ditë pune për secilin LOT.</li> <li>9.Nji Ingjinjer apo teknik i pylltarisë me dëshmit Diploma-kopje, Kontrata e punës,CV).</li> <li>10.Specifikacioni per Mekanizmin në dispozicion së paku prej -a)traktor për tërheqje se paku dy. b) kamion transportues se paku 2, c)sharra motorrike se paku 2.</li> </ol> <p><b>LOT 1 -Lista e projektve nga lëmia e shfrytzimit të pyjeve së paku në vlerë min. 43.000,00€ të realizuara në trevjeshin e fundit.(Kontratat dhe referencat).</b></p> <p><b>LOT 2 -Lista e projektve nga lëmia e shfrytzimit të pyjeve së paku në vlerë min. 69.000,00€ të realizuara në trevjeshin e fundit.(Kontratat dhe referencat).</b></p> |

### 4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në E06 Njoftim per Dhenie te Kontrates per Shitje të autoritetit kontraktues të datës 08.06.2022, është konstatuar si në vijim: AK- Komuna – Kaçanik, shpërblen me kontratë operatorin ekonomik NTSH "Dardani" nga f. Korbuliq LOT I ne shume prej 45.511.96€ Metë Muriqi B.I nga Peja LOT II në shume prej 95.213,03€

### 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A



## 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

## 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

**Sqarim hyrës:** Autoriteti kontraktues Komuna – Kaçanik, ka zhvilluar procedurë te hapur, lloji i kontratës Ankand publik, kriteri i dhënies – çmimi me i lartë. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Gjithashtu, sqarojmë se ankesa nuk është e ngarkuar në platformën e-prokurimit, por është pranuar si kopje fizike pran OSHP-së, ndërsa dosja e tenderit dhe njoftimet tjera, ofertat janë të ngarkuara në sistemin e prokurimit. AK në DT ka përcaktuar kriteret e dhënies së kontratës, ku gjatë trajtimit të kësaj ankese, do të paraqiten këto kritere të dosjes së tenderit.

### **Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) NTSH “Dardani”- Kaçanik**

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lendes kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues NTSH “Dardani”- Kaçanik, pretendon se AK ka bërë diskriminim në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së sepse AK ka shpërblyer me kontratë OE i cili ka qenë i dënuar nga Gjykata kompetente për dëme pyjore e cila ceket në vërtetimin e APK-s, dhe pretendon se AK ka kërkuar vërtetimin nga APK që nuk duhet të kenë dënime dhe atë vërtetim të kompanisë “Dromodoli Comerc” ceket qartë se ka qenë i dënuar për dëme pyjore. Tutje, OE ankues pretendon se AK ka kërkuar sqarim nga Inspektorati Qendror i Kosovës, ku në përgjigje specifikon: CITIM-me anë të secilës ja kemi konfirmuar se jo vetëm që ka procedurë të iniciuar por kemi edhe Aktgjykim të Gjykatës me dënim që ka vërtetuar procedurën tonë, ku keni faktet edhe të dy vërtetimeve të ndryshme nga APK-ja (me datën 16.06.2021 ka marr një vërtetim se nuk ka dënime për vazhdimin e licencës, ndërsa me datën 04.05.2022 ka marr vërtetimin se kompania në fjalë ka pas dënime dhe të Formës së prere. OE ankues në vazhdim të pretendimit cek AK veçanërisht APK ka të hartuar Udhëzime Administrative ku janë të parapara sanksionet për kompanitë të cilat ka kallëzime penale e në veçanti rasti i OE “Dromodoli Comerc” ka dhe Aktgjykim të prerë nga gjykata kompetente dhe cilat janë masat që janë ndërmarr për këtë OE që parashihen me Udhëzime Administrative ku janë të parapara sanksionet për kompanitë të cilat ka kallëzime penale e në veçanti rasti i OE “Dromodoli Comerc” ka dhe Aktgjykim të prerë nga gjykata kompetente dhe cilat janë masat që janë ndërmarr për këtë OE që parashihen me Udhëzim Administrativ me **nr.15/2006** neni 15 Licenca mund ti hiqet personit (subjektit) nëse vepron në kundërshtim me ligjin dhe kushtet e licencës dhe Udhëzim Administrativ me **nr.30/2008** neni 11 Citon “Departamenti i Pylltarisë mbi bazën e provave të vërtetuara nga inspeksioni i

pylltarisë organi kompetent menaxhues me pyjet dhe organe tjera kompetente ia heq të drejtën e përdorimit të licencave për një periudhë prej 2 deri në 5 vjet, subjekteve juridike nëse:

- a) Me veprimtarinë e tyre kanë shkaktuar dëme ose kundërvajtje në pyje;
- b) Janë shkaktarë të mos shlyerjes së detyrimeve kontraktuese gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre dhe
- c) Gjatë zhvillimit të aktivitetit me veprimin ose mosveprimin e tyre shkaktajnë shkelje të këtij Udhëzimi Administrativ dhe dispozitave ligjore në fuqi.

**Ekspertja shqyrtuese** për këtë pretendim sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

|                    |      |  |
|--------------------|------|--|
| Kriteret e Dhënies | 21.1 | <p><i>[Dhënia e kontratës do të bazohet në çmim me i lartë dhe në faktorët në vijim]</i></p> <p><i>[shëno faktorët]</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Regjistrimi i biznesit me shifrat e veprimtarisë. Përkatëse</li> <li>2. Çert. e nr. fiskalë nese nuk eshte ne cerrt. e biznesti. (kopje)</li> <li>3. Çert. e TVSH-se. (kopje)</li> <li>4.Licenca per eksploatimin e pyjeve -valide. (kopje)</li> <li>5. Dëshmia nga Gjykata kopetente se nuk është në procedur të ndjekjes të prerjes ilegale të pyjeve apo transport ilegal.</li> <li>6. Dëshmi nga DBZHRP-je (sektori i pylltarisë Kaçanik) se kunder subjektit përkatës nuk ka të ngritur procedur për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime të pa kryera nga kontratat e mëparme.</li> <li><b>7. Dëshmi nga APK-Inspektorati qendror i Kosovës se kunder subjektit përkatës dhe Menagjerit nuk ka të ngritur procedur për dëme pyjore.</b></li> <li>8.Planik dinamik. Jo më shumë se 40 ditë pune për secilin LOT.</li> <li>9.Nji Injiner apo teknik i pylltarisë me dëshmit Diploma-kopje, Kontrata e punës,CV).</li> <li>10.Specifikacioni per Mekanizmin në dispozicion së paku prej -a)traktor për tërheqje se paku dy. b) kamion transportues se paku 2, c)sharra motorrike se paku 2.</li> <li>LOT 1 -Lista e projektve nga lëmia e shfrytimit të pyjeve së paku në vlerë min. 43.000,00€ të realizuara në trevjeshin e fundit.(Kontratat dhe referencat).</li> <li>LOT 2 -Lista e projektve nga lëmia e shfrytimit të pyjeve së paku në vlerë min. 69.000,00€ të realizuara në trevjeshin e fundit.(Kontratat dhe referencat).</li> </ol> |
|--------------------|------|--|

Pra, në pikën 7 të Kriteret e Dhënies (në dosje të tenderit), AK ka kërkuar **“Dëshmi nga APK-Inspektorati Qendror i Kosovës se kundër subjektit përkatës dhe Menagjerit nuk ka të ngritur procedurë për dëme pyjore.”** Për këtë kërkesë, OE i rekomanduar me tender ka bashkangjitur dokumentin me titull “Vertetim APK- ja pdf”,

të lëshuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), dokumentin me numër të protokollit 1764 me numër të referencës APK-DL-103/2022 të datës 04.05.2022, ku thuhet se OE N.T.P. “Dromodoli Comerc” vërtetohet se OE i lartcekur nuk figuron si debitor dhe nuk ka obligime financiare ndaj APK-së. Po ashtu në këtë dokument ceket “referuar konfirmimeve të Inspektorëve dhe të dhënave të krahasuara me librin e protokollit i njëjti ka pasur të ngritur një fletë parqitje kundërvajtje me datë 18.05.2019 nga inspektorati por i njëjti sipas Aktgjykimit me nr.292/19 dt. 9.07.2019 i ka kryer të gjitha obligimet dhe e njëjta nuk përbën pengesë administrative për këtë procedurë. Po ashtu në këtë dokument APK cek: Vërtetimi i lëshohet vetëm për aplikim në procedurë të ankandit publik në APK dhe për qëllime tjera nuk mund të perdoret.

**Ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK gjatë ri vlerësimit duhet të kërkoj sqarime shtesë nga AKP duke kërkuar aktgjykimin Nr. 292/2019 të datës 29.07.2019 dhe të vlerësoj sipas Aktgjykimit nëse OE i rekomanduar është i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së. Andaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

Sqarojmë se ne ankesën e dorëzuar nga OE ankues NTSH “Dardani”- Kaçanik, është bashkangjitur shkresa me numër 2629 dhe numër reference KE-436/21 të datës 16.06.2021, lëshuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), në të cilin dokument ceket se OE N.T.P. Dromodoli Commerce” Metë Muriqi B.I. nuk figuron si debitor dhe nuk ka obligime financiare ndaj APK-së. Po ashtu në këtë dokument APK cek: *Ky vërtetim vlen për vazhdim të Licencës sipas kërkesës së palës dhe i njëjti nuk mund të përdoret për çështje tjera.* OE ankues në ankesë potencon se AK ka kërkuar vërtetimin nga APK, përkatësisht Inspektorati i Kosovës me ç’rast OE Dromodoli ka sjellë vërtetimin nga APK, ku ceket se OE në fjalë ka pasur të ngritur fletëparaqitje, ku nga zyrtari i përgjegjës që lëshon vërtetimin është cekur që kjo procedura nuk bën shkelje ligjore, i njëjti zyrtar në vitin 2021 e fsheh dënimin dhe lëshon vërtetimin për licencim duke cekur që OE nuk ka dënim ndërsa në vitin 2022 e cek që ka pas dënim por nuk bënë shkelje dhe nuk i pengon për pjesëmarrje në ankandet publike. Këtu ka vend edhe për krime ekonomike. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se lëshimi i vërtetimeve të tilla është në përgjegjësi të APK-së dhe nuk është në mandatin e ekspertit që të shqyrtoj procedurën e lëshimit të vërtetimeve të tilla. Në rast se OE ankues ka dyshime se ka shkelje me rastin e lëshimit të vërtetimeve dhe fshehje të dënimit nga APK, atëherë duhet ti drejtohet organeve kompetente. Megjithatë, AK-Komuna-Kaçanik, gjatë rivlerësimit duhet të sqarojë Aktgjykimi me nr.292/19 i dt. 09.07.2019, ashtu siç është cekur më lartë në lidhje me pretendimin që ka të bëjë me pranueshmërinë e kandidatëve ose tenderuesve sipas nenit 65 të LPP-së.

Sqarojmë se OE i rekomanduar me rastin e ofertimit ka dorëzuar Licencën e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Departamenti i Pylltarisë - Për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve me nr. 28/2021 në emër të biznesit me numër 810403337 – Metë Muriqi me datë të lëshimit 16.06.2021 me vlefshmëri deri me dt 16.06.2026.

**Pretendimi tjetër i OE** ankues ka të bëjë me dokumentacionin e OE ”Dromodoli Comerc”, ku në ankesë potencon shifet se në listën e Mjeteve themelore ka të cekura dy traktor të marr me qira nga një OE tjetër i cili nuk posedon dokumentacion që përmban në emrin e tij, nuk posedon as librezë të qarkullimit të traktorëve sipas mendimit tonë jo valide.

**Ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK te pika 10 e Kriteve për Dhënie ka kërkuar: 10. Specifikacioni për Mekanizmin në dispozicion së paku prej

- a) traktor për tërheqje së paku dy.
- b) kamion transportues së paku 2,
- c) sharra motorrike së paku 2.

OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur dokumentin me titull “Lista e pajisjeve.pdf”, ku në këtë dokument janë gjithsej 7 mjete dhe 3 sharra. Ankuesi potencon se dy traktor të marr me qira nga një OE tjetër i cili nuk posedon dokumentacion që përmban në emrin e tij dhe nuk posedon as librezë dhe nuk janë valide, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se në këtë dokument janë 2 traktor, ku në listën e pajisjeve me numër rendor 6 është traktori me markë dhe tip “Case International 4230” i vitit 1994 me ngjyrë të kuqe/zezë dhe me numër serik 4230AXLIJE0901371, kurse në listën e pajisjeve me numër rendor 7 është traktori me markë dhe tip “Massey Ferguson (GB) FE35” i vitit 1981, me ngjyrë të kuqe/hirit me numër serik SNMY290256. Për këta dy traktor, OE i rekomanduar ka bashkangjitur si dëshmi kontratën mbi qiranë e lidhur mne 06.05.2022 ndërmjet N.T.P. “Dromodoli Comerc” nga Peja në cilësinë e qira marrësit dhe “Joos Krasniqi – Baze” Sh.p.k. në cilësinë e qiradhënësit. Në këtë kontratë janë dhënë specifikat e mjeteve, me specifikat e cekura si më lartë. Pretendimi i ankuesit është se dy traktor të marr me qira nga një OE tjetër i cili nuk posedon dokumentacion që përmban në emrin e tij dhe nuk posedon as librezë dhe nuk janë valide, **ekspertja shqyrtuese sqaron** se në faqe 11 të dokumentit me titull “Lista e pajisjeve.pdf” gjendet fatura 16-SHV01-002-9 e lëshuar nga N.P.T. “NOLI” si shitës, kurse Joss&Krasniqi –Bazë Sh.p.k. si blerës i traktorit Case International 4230, ku vlera e faturës është 15,500. faqe 12 të këtij dokumenti është bashkangjitur edhe dokumenti unik doganor i lëshuar në emër të N.P.T. “NOLI” me rastin e importit të këtij traktori. Po ashtu ne faqe 14 të dokumentit “Lista e pajisjeve.pdf” është

edhe fatura për traktorin Massey Ferguson (GB) Fe, ku blerës është Joss&Krasniqi-Baze Sh.p.k. dhe shitës N.P.T. "NOLI" sipas faturës 16-SHV01-001-54 me vlerë 3,000.00 euro. Po ashtu te dokumenti lista e pajisjeve në faqe 15 gjendet dokumenti unik doganor në emër të importit nga N.P.T. NOLI me rastin e importit të këtij traktori.

Sqarojmë se OE i rekomanduar posedon kontratë mbi marrjen me qira të këtyre dy traktorëve, në shkresa gjenden DUD-at doganor dhe faturat e blerjes nga dhënësi me qira i traktorëve. Andaj pretendimi është i pa qëndrueshëm.

Pika tjetër ankimore e OE ankues është: gabimet që kemi parë në dokumentacionin e OE "Dromodoli Comerc" në dëshmi nga DBZHRP-je komunale kemi hasur në nr. e biznesit 80237707 ku te deklaruar ka tatimet 00.00 e që nuk përputhen me nr. e biznesit që posedon në Licencë.

Për këtë pretendim ankimor, **ekspertja shqyrtuese sqaron** se ARBK me datë 23.04.2019 ka lëshuar njoftimin në faqen zyrtare se duke u bazuar në zbatim të Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare - Numrin Unik Identifikues (NUI) dhe implementimi i platformës se re për regjistrimin e bizneseve në ARBK, ju njoftojmë se Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) nga data 11 Shkurt 2019 ka lansuar platformën e re elektronike për regjistrimin online të bizneseve, përmes sistemit ju mund të aplikoni për regjistrimin e bizneseve, kërkesa për ndryshim dhe shërbime të tjera. Për të hyrë në sistem ju kërkohet që paraprakisht të keni llogari të konfirmuar në sistem.

Gjithashtu edhe Administrata Tatimore e Kosovës ka lëshuar njoftim në lidhje me numrin unik identifikues si më poshtë:

*Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se të gjitha shënimet e regjistrimit duke përfshirë deklarin, arkën fiskale dhe numrin e TVSH mbeten të vlefshme deri në konsolidimin në NUI.*

*Për çdo informate shtesë ju lutem drejtohuni pranë Zyrave Rajonale të Administratës Tatimore.*

Pra NUI (numri unik identifikues) është numri i regjistrimit të biznesit i lëshuar nga ARBK dhe NUI është i vlefshëm për identifikimin e Shoqërisë Tregtare për këto qëllime:

- Regjistrimi në regjistër të ARBK;
- Detyrimet tatimore dhe doganore,
- Kontributet pensionale,
- Sigurimet shëndetësore,
- Për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës,
- Si dhe për çdo qëllim tjetër të përcaktuar me ligj.

Ekspertja sqaron se edhe nese kërkojmë në ARBK me NUI 810403337 të OE “Dromodoli Commerce” dalin shënimet apo të dhënat e njëjta sikurse në shkresa:

### Metë Muriqi B.I.

|                         |                             |
|-------------------------|-----------------------------|
| Emri i biznesit         | Metë Muriqi B.I.            |
| Emri tregtar            | N.T.P. " Dromodoli Comerc " |
| Lloji biznesit          | Biznes individual           |
| Numri unik identifikues | 810403337                   |
| Numri i biznesit        | 80237707                    |
| Numri fiskal            | 600425319                   |
| Numri certifikues KTA   | ///                         |
| Numri punëtorëve        | 1                           |
| Data e regjistrimit     | 14/09/2000                  |
| Komuna                  | Pejë                        |
| Adresa                  | Pejë, Zhuj Selmani          |
| Telefoni                | 044-415-288                 |
| E-mail                  | ///                         |
| Kapitali                | €                           |
| Statusi në ARBK         | Regjistruar                 |
| Statusi në ATK          | ///                         |

### Perfaqësues i autorizuar

| Emri | Mbiemri | Pozita në biznes     | Autorizimet |
|------|---------|----------------------|-------------|
| Metë | Muriqi  | Agjent i regjistruar |             |

### Pronar/ Aksionarë

| Emri Mbiemri | Kapitali në € | Kapitali në % |
|--------------|---------------|---------------|
| Metë Muriqi  | €             | %             |

### Njësitë

Po ashtu në faqe 2 të dokumentit me titull “qertifikata e biznesit, fiskal, tvsh.pdf” dorëzuar me rastin e ofertimit, ceket:



Informata mbi biznesin  
Information about business  
Informacija o biznisu

Numri unik identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number  
810403337

Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak

; Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 80237707 , me zbatimin e ligjit për numrin unik të identifikues të biznesit ka këtë numër NUI: 810403337

Pra NUI të bizneset është numër i personalizuar sikurse numri personal të qytetarët, dhe identifikimi i shoqërive tregtare bëhet në bazë të NUI. Andaj, ky pretendim është i pa qëndrueshëm.

Pretendimi tjetër është: në vërtetim nga APK përpos dënimit që kemi të cekur vërtetimi nuk përmban numrin e biznesit të OE që saktëson pjesën e të dhënave të kompanisë.

**Ekspertja shqyrtuese sqaron se në shkresën e APK me numër prot. 1764 dhe numër reference APK-DL-103/2022 shihet që bëhet fjalë për OE “Dromodoli Comerc” dhe ceket me përfaqësues Metë Muriqi.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues NTSH “Dardani”- Kaçanik, se në informatat e biznesit kemi parë që OE në fjalë nuk përmban as kodin me nr. 0220 i cili specifikon “Prerjen e Drunjeve”.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK si kërkesë në pikën 1 të kriteret e dhënies e ka cekur:

**1.Regjistrimi i biznesit me shifrat e veprimtarisë. Përkatëse**

Ndërsa pas shqyrtimit të veprimtarive të informata mbi biznesin si dhe kërkesës së AK-së, shihet se OE i rekomanduar Metë Muriqi B.I (NTP “Dromodoli Comerc”), si veprimtari kryesore ka prodhimi i produkteve tjera nga druri, ndërsa veprimtari sekondare ka shërbime mbështetëse ndaj pyjeve, kulturat pyjore dhe aktivitete tjera të pylltarisë, etj. Gjithashtu, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK nuk e ka specifikuar askund në dosje të tenderit kodin me nr.0220 “Prerjen e Drunjeve” siç pretendon OE ankues.

Përfundimisht, në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandimi ynë për AK-Komuna-Kaçanik është që lëndën ta kthej në ri vlerësim me qëllim që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të vendosura në dosje të tenderit, të sqarohet çështja e Aktgjykimit me nr.292/19 i dt. 09.07.2019, dhe të sigurohet që operatori ekonomik i cili rekomandohet për kontratë të plotësoj kërkesat e specifikuar në nenin 65 të LPP-së.

**Provë: bashkangjitur me raport gjeni kopje :**

**Vërtetimin Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), me numër të protokollit.1764 me numër të referencës APK-DL-103/2022 të datës 04.05.2022 dhe Licencën e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Departamenti i Pylltarisë nr. 28/2021.**

## **8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, si dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - Komuna – Kaçanik

Panelit Shqyrtues - OSHP.

- OE ankues - NTSH “Dardani”- Kaçanik